

NËNTOR 2025

BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

94 TË RINJ E TË REJA TË CERTIFIKUAR NË PËRFUNDIM TË PRAKTIKËS 3 MUJORE TË PUNËS PRANË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS



94 studentë të cilët zhvilluan praktikën 3 mujore të punës pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas u certifikuan në një ceremoni të zhvilluar në praninë e Ministrit të Drejtësisë z. Besfort Lamallari, Zëvendës Ministres së Drejtësisë znj. Elona Hoxha, Drejtoreshës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas znj. Patricia Pogaçe dhe Dekanes së Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës znj. Dorina Hoxha.

VIZITË E DELEGACIONIT AUSTRIAK NË QENDRËN E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE KUKËS



Z. Walter Ehmeir, Shefi i Departamentit të Programeve dhe Projekteve, ADA Vjenë, z. Andreas Liebmann, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Partneritetet Ndërkombëtare dhe Ndihmën Humanitare, Ministria Federale Austriake për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare, z. David Muckenhuber, Kreu i Zyrës Rajonale të Agjencisë Austriake për Zhvillim dhe përfaqësues të UNDP Albania vizituan Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kukës.

DREJTORESHA E PËRGJITHSHME (E KOMANDUAR) E DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS MORI PJESË NË AKTIVITETIN E ORGANIZUAR NGA CARITAS SHQIPTAR DHE QNL

Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndihmës Juridike znj. Patricia Pogaçe ishte pjesë e konferencës të organizuar nga Caritas Shqiptar dhe Qendra për Nisma Ligjore Qytetare me temë: 'Efektet e hartës së re gjyqësore mbi viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Mësime për të ardhmen'.



INTERVISTË E DREJTORESHËS SË PËRGJITHSHME (TË KOMANDUAR) TË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS PËR PODCASTIN 'PROLIGJ'



Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndihmës Juridike zhvilloi një intervistë në podcastin 'Proligj' ku foli për ndihmën juridike falas, përfituesit e këtij shërbimi dhe Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.

AKTIVITETE TË QENDRAVE E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

QSHNJP Përmet në datën 18 Nëntor, në kuadër të Ditës për Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve, Abuzimi dhe Dhuna zhvilloi një aktivitet informues dhe ndërgjegjësues me strukturat e Policisë së Këlcyrës, me fokus forcimin e mekanizmave institucionalë për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, dhuna dhe shfrytëzimi.



QSHNJP Pogradec në datën 05.11.2025 mori pjesë në aktivitetin kushtuar Ditës Botërore të Gjuhës Rome, organizuar për promovimin e gjuhës, kulturës dhe identitetit rom, si dhe për forcimin e bashkëjetesës dhe mbështetjes ndaj komunitetit rom.

QSHNJP Pogradec në datën 12.11.2025 mori pjesë në takim informues me anëtarët e MKR të Bashkisë Pogradec, lidhur me projektligjin e ri "Për Masat Kundër Dhunës në Familje dhe ndaj Grave", i prezantuar nga ACPD me mbështetjen e UNFPA.



QSHNJP Fier me datë 03.11.2025 zhvilloi një aktivitet pranë Qendrës me një Ndalesë (One Stop Center) pranë Spitalit Fier, me Koordinatorën e Qendrës, Psikologjen dhe Juristen e Spitalit Fier. Kjo Qendër trajton rastet e fëmijëve të prekur nga abuzimi dhe forma të rënda të dhunës, si dhe dëshmitarë dhune.

QSHNJP Fier në datë 27.11.2025 zhvilloi një aktivitet pranë Njesisë Administrative Libofshë, Bashkia Fier, në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore



QSHNJP Fier zhvilloi në datën 17.11.2025 n një tryezë ndërinstucionale me përfaqësuesit e institucioneve vendore, Shërbimit Social Shtetëror, Koordinatorën e Dhunës në Familje, Koordinatorën e Mbrojtjes së Fëmijëve, Policinë si dhe KMD, me qëllim diskutimin mbi ecurinë e bashkëpunimit, problematikat e konstatuara dhe adresimet për zgjidhje



QSHNJP Fier në datën 18.11.2025 zhvilloi një takim informues me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri” në bashkëpunim me “Qendrën me një Ndalesë”, në kuadër të Ditës Botërore për Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve, Abuzimi dhe Dhuna.

QSHNJP Fier në datë 26.11.2025 mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Bashkia Fier, në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë dhe institucionet vendore, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave



QSHNJP Shkodër zhvilloi një takim me përfaqësuese të Shtëpisë së Fëmijës 6-15 vjeç, në kuadër të Ditës Botërore për Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve, duke vënë në fokus bashkëpunimin për mbrojtjen e fëmijëve dhe rolin e ndihmës juridike në garantimin e aksesit në drejtësi për këtë kategori.

QSHNJP Shkodër më datë 26.11.2025 mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë” në Shkollën “Prenk Jakova”, në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe projektit “Krenar të kemi të drejta”.



QSHNJP Tiranë në datën 12.11.2025 ishte pjesë e trajnimit me temë: “Të drejtat e konsumatorit – Kategoritë që preken (neni 12 / neni 11/dh)”.

QSHNJP Tiranë në datën 18.11.2025 organizoi një tryezë pune me Qendrën Barazi dhe Përfshirje mbi problematikat e trajtimit të rasteve të shfrytëzimit seksual dhe abuzimit të fëmijëve, në kuadër të Ditës Botërore për Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve, Abuzimi dhe Dhuna.



QSHNJP Lezhë u ftua ne takimin e organizuar nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, në kuadër të startimit të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore.

QSHNJP Lezhë në datën 25.11.2025 ishte pjesë startimit të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore, të organizuar nga Bashkia Lezhë.



QSHNJP Lezhë në datë 26.11.2025, në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, u zhvillua një takim ndërgjegjësues në bashkëpunim me Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Lezhë dhe aktorët e Ekipit Teknik Ndërsektorial



QSHNJP Korçë në datën 06.11.2025 mori pjesë në mbledhjen e grupit ETN për rastin e L.M, ku u evidentua nevoja për përfitimin e ndihmës juridike dytësore si viktimë e dhunës në familje për çështje të zgjidhjes së martesës.



QSHNJP Korçë në datën 12.11.2025 mori pjesë në Forumin Rajonal “Barazia gjinore, maskuliniteti pozitiv dhe angazhimi i djemve dhe burrave”, me qëllim nxitjen e përfshirjes së tyre si aleatë kundër dhunës me bazë gjinore.

QSHNJP Korçë në datën 14.11.2025 zhvilloi një aktivitet ‘Street Law’ për të informuar qytetarët mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti.



QSHNJP Korçë në datën 18.11.2025 zhvilloi një aktivitet në kuadër të Ditës Botërore për Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve, Abuzimi dhe Dhuna në ambjentet e Komisariatit të Policisë Korçë.

QSHNJP Korçë në datën 20.11.2025 në kuadër të Ditës Botërore të të drejtave të fëmijëve ,mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Korçë në Qytezën e Fëmijëve. Pjesëmarrja në këtë aktivitet shërbeu për forcimin e bashkëpunimit me strukturat vendore dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e fëmijëve.



QSHNJP Korçë në datën 25.11.2025, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Eliminimit të Dhunës ndaj Grave ishte pjesë e aktivitetit realizuar në pedonalen e qytetit.

QSHNJP Korçë në datën 26.11.2025 mori pjesë në aktivitetin me temë: “Jo Martesa të Hershme”, që shënoi fillimin e fushatës së këtij viti nga UNFPA Shqipëri në bashkëpunim me AICS, përmes premierës së shfaqjes teatrale “Një grua për shtëpi”.

QSHNJP Kukës në datën 14.11.2025 mori pjesë në eventin “Royal Tea Party” të organizuar nga Ambasada Britanike në Shqipëri, në kuadër të ditëlindjes së Mbretit Charls III.



QSHNJP Kukës në datën 18.11.2025 mori pjesë në takimin me nxënës të shkollës së mesme "Havzi Nela" Kukës.



QSHNJP Kukës në datën 20.11.2025-21.11.2025 mori pjesë në takimin e quajtur "Programi Forumit të Komunitetit & Biznesit - Kukës".



QSHNJP Kurbin në datë 18.11.2025, zhvilloi një aktivitet në kuadër të Ditës Botërore për Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve, Abuzimi dhe Dhuna, në ambientet e Bashkisë Kurbin.

QSHNJP Kurbin në datën 21.11.2025 është ftuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) për të marrë pjesë në tryezën ndërgjegjësuere dhe informuese mbi njohjen me gjetjet e raportit të monitorimit të vendimeve gjyqësore mbi rastet e Seksionit VI të Kodit Penal "Krimet seksuale" .



QSHNJP Kurbin në datën 26.11.2025 në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave ka organizuar një takim pranë Njesisë Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin, ku pjesmarrës ishte administratori i kësaj njësie z. Florjan Paloka, si dhe Specialistë të Shërbimit Social Mamurras.

QSHNJP Gjirokastrë në datën 25.11.2025, në kuadër të 25 Nëntorit - Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, u zhvillua një aktivitet ndërgjegjësues për promovimin e barazisë gjinore, forcimin e mekanizmave të mbrojtjes dhe nisjen e fushatës globale "16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës në Bazë Gjinore", me synim nxitjen e veprimit institucional dhe komunitar.



QSHNJP Mat në datën 18.11.2025 në kuadër të Ditës Botërore për Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve, Abuzimi dhe Dhuna, zhvilloi një takim informuese me nxënës dhe staf mësimor.

QSHNJP Mat në datën 19.11.2025 ishte pjesë e takimit të Grupit Teknik Ndërsektorial.

QSHNJP Mat në datën 26.11.2025 ishte pjesë e një workshopi me anëtarët e "Mekanizmit të Referimit" dhe "Ekipit Teknik Ndërsektorial" në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional për rastet e dhunës në familje.



QSHNJP Elbasan në datën 07.11.2025 zhvilloi një takim pranë Komisarariatit të Policisë Cërrik me personelin e gatshëm, ku u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale mbi mënyrën e përfitimit të ndihmës juridike.



QSHNJP Elbasan në datën 14.11.2025, mbledhi në një tryezë ndërinstitucionale të gjithë aktorët vendor ku kishte pjesëmarrës nga Bashkia Elbasan, Prokuroria , Zyra e Punës , Shërbimi Social, Word Vizion, Forumi i Gruas dhe Koordinatorët e Dhunës në Familje.



QSHNJP Elbasan në datën 18.11.2025 zhvilloi një aktivitet pranë gjimnazit “Mahir Domi” ku e pranishme ishte edhe punonjësja sociale znj.Bora Dybeli, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi seksual Abuzimi dhe Dhuna e Fëmijëve.



QSHNJP Elbasan në datën 25.11.2025 zhvilloi një aktivitet sensibilizues dhe ndërgjegjësues pranë Fondacionit Joscelyn, me pjesëmarrjen e kategorive drejtpërdrejt përfituese të ndihmës juridike në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave.

QSHNJP Elbasan në datën 25.11.2025 në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan dhe anëtarët e MKR-së, zhvilloi një aktivitet sensibilizues në sheshin “Genshër” në qytetin e Elbasanit, në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore.



QSHNJP Dibër në datën 20.11.2025, në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, zhvilloi një takim në zyrat e Njesisë Vendore, Maqellarë, Bashkia Dibër.



QSHNJP Dibër në datën 25.11.2025, në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, zhvilloi një takim sensibilizues mbi ndihmën juridike falas pranë Bashkisë Bulqizë.



QSHNJP Durrës në kuadër të Ditës Botërore për Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve, Abuzimi dhe Dhuna, realizoi një takim sensibilizues në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, me pjesëmarrjen e punonjësve të policisë, Shefit të Seksionit të Krimeve dhe Koordinatorës së Dhunës në Familje.

QSHNJP Kavajë dhe Durrës në datën 14.11.2025 morën pjesë në Takimin informues - Lista udhëzuese për Asistencën Personale, në të cilën synohet mbështetja për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) në Shqipëri.

QSHNJP Kavajë në kuadër të Ditës Botërore për Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve, Abuzimi dhe Dhuna, realizoi një takim sensibilizues në Komisarjatin e Policisë Kavajë, me Shefin e Krimeve dhe Oficerë të Policisë së Zonave.



QSHNJP Kavajë dhe QSHNJP Durrës morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga shoqata “Gender, Paqe dhe Siguri”, në kuadër të Ditës Botërore kundër Dhunës me Bazë Gjinore.

